



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
2-D/DPK	01-83/15
Nr. f. lag. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	16.01.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.01.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4264/14, për z. Blerim Sokoli, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Blerim Sokoli, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë, me këtë rast ai është bindur me fakte për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Zyrtari i lartë z. Sokoli, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të kërkuara po zgjatë Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet “njoftimi paralajmërues”, me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të heq dorë nga funksioni i të qenurit person i autorizuar në biznesin privat, përndryshe do të pasojnë masat sanksionuese të parapara me ligj.

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Sokoli ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/56/15) në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat N.T.Sh Chip S&S”, për të ushtruar funksionin e tij publik..

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

